

EPPC Albania për klientin e saj, kompani që operon në tregtimin e materialeve elektrike, kërkon një **Menaxher Projekti (Inxhinier Elektrik)**.

Përgjegjësitë kryesore:

- Përgatit të gjithë dokumentacionin e nevojshme për fillimin e punës në objekt;
- Përgjegjës për përgatitjen dhe kontrollin e vazhdueshëm të një plan buxhet të plotë për projektin mbasi ka kontrolluar vizatimet e projektit, specifikimet e tij, kontratën dhe ofertën e miratura nga investori / kontraktori;
- Planifikon dhe përgatit planin e punës për projektin në përputhje me planin e projektit të ndërtimit;
- Planifikon fuqinë punëtore me Drejtuesin Teknik;
- Përgjegjës për evidentimin e bazës materiale në objekt dhe sigurimin e tyre në bashkëpunim me departamentet përkatëse;
- Bashkëpunon me Inxhinierin e kantierit për të analizuar kërkesat për bazë materiale nëse janë në përputhje me projektin elektrik dhe i dërgon ato tek furnitori për porosi;
- Monitoron me Inxh. e Kantierit ose Skuadrën e Punës ecurinë e punimeve ndërtimore;
- Në bashkëpunim me Inxhinierin e kantierit përgatit dhe propozon tek administratori ofertën për kërkesa të projektit për zëra të parashikuara në kontratë;
- Negocion dhe zgjidh kërkesat e klientit;
- Asiston kostoistin me informacione teknike që shërbejnë për menaxhimin e aspektit financiar të projektit;
- Përfaqeson kompaninë në takime nga investitori/kontraktori lidhur me projektin;
- Menaxhon faturimin e objektit duke u dakortësuar me departamentin e Financës dhe të dorëzojë në kohë dokumentacion e kërkuar për të mundësuar faturimin mujor;
- Përgatit dhe dorëzon të gjithë dokumentacionin për procedurat e mbylljes së projektit sipas kontratës ose sipas kërkesave të investitorit.
- Raporton në mënyrë direkte tek Administratori i kompanisë dhe merr raporte nga inxhinieri i kantierit dhe/ose direkt nga skuadra e punës.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Të ketë përfunduar studimet e larta në Automatizim, Energjitike, Elektrike Etj;
- Të disponojë çertifikata apo kualifikime të ndryshme;
- Mbi 3-4 vite eksperiencë në menaxhimin e një projekti;
- Përdorim të Autocad dhe të paketës Microsoft Office (Word, Excel);
- Leje Drejtimi Kategoria B;
- Të ketë njohuri të mira në gjuhët e huaja anglisht/italisht;

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.